

VENDIM
Nr.397, datë 20.5.1996

PËR MBROJTJEN E VEÇANTË TË GRAVE SHTATZËNA DHE TË AMËSISË

Në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Mbrojtja e aftësisë për të qenë nënë

1. Ndalohet zënia me punë e grave, kur janë ende të afta për të bërë fëmijë, në veprimtaritë që parashikohen në një listë të përgatitur nga Këshilli i Ministrave.

Vlerësimi i rreziqeve

2. Për çdo veprimtari që paraqet rrezik ekspozimi ndaj agjentëve, proceseve ose kushteve të punës të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, natyra, shkalla dhe kohëzgjatja e ekspozimit ndaj tyre e grave shtatzëna, lehonave apo nënave me fëmijë në gji duhet të vlerësohen nga punëdhënësi, me qëllim që:

a) të merret parasysh çdo rrezik për sigurinë dhe shëndetin, si dhe çdo pasojë mbi shtatzëninë dhe të dhënit e gjirit të fëmijës;

b) të përcaktohen masat që duhen marrë.

Përshtatja e kushteve të punës

3. Nëse rezultatet e vlerësimit të parashikuar në pikën 2 nxjerrjen në pah qenien e një rreziku për shëndetin, sigurinë a një pasojë mbi shtatzëninë ose të dhënit e gjirit të fëmijës, punëdhënësi duhet të marrë të gjitha masat, në mënyrë që nëpërmjet përshtatjes së përkohshme të kushteve të punës apo të kohës së punës, ekspozimi i kësaj kategorie punonjësish të mënjanohet.

Nëse përshtatja e kushteve ose e kohës së punës nuk është teknikisht a objektivisht e mundur, ose nuk mund të kërkohet për arsye të justifikueshme, atëherë punëdhënësi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për t’i siguruar punonjësën në fjalë një ndërrim vendi pune.

Nëse ndërrimi i vendit të punës nuk është teknikisht apo objektivisht i mundshëm ose nuk mund të kërkohet për arsye të justifikueshme, punonjësja në fjalë lirohet nga puna për një periudhë të nevojshme për mbrojtjen e sigursë apo të shëndetit të saj.

Veprimtaritë e ndaluara

4. Gratë shtatzëna nuk mund në asnjë rast të detyrohen të kryejnë veprimtari që paraqesin një rrezik ndaj ekspozimit me agjentët ose kushtet e punës, të parashikuara në një listë të përgatitur nga Këshilli i Ministrave e që vënë në rrezik sigurinë a shëndetin e tyre.

Nënat me fëmijë në gji nuk mund në asnjë rast të detyrohen të kryejnë veprimtari që paraqesin një rrezik ndaj ekspozimit me agjentët ose kushtet e punës, të parashikuara në një listë të përgatitur nga Këshilli i Ministrave e që vënë në rrezik sigurinë a shëndetin e tyre.

Kohëzgjatja e punës për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji

5. Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji nuk mund të detyrohen të fillojnë punën e ditës para orës pesë në verë (apo gjashtë në dimër) dhe as të vazhdojnë atë pas orës 20.

Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji kanë të drejtë që të kërkojnë të marrin leje nga puna; punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë paraqitjen e një raporti mjekësor.

Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji kanë të drejtë të bëjnë pushime herë pas here gjatë ditës, me kusht që këto pushime të justifikohen nga gjendja e tyre.

Kur gruaja s’mund të kryejë një punë për arsye të rrezikut që ajo paraqet, atëherë punëdhënësi duhet t’i caktojë një punë tjetër dhe në pamundësi t’i paguajë pagën.

Shqyrtimi i listave

6. Inspektorati Shtetëror i Punës kujdeset që listat e veprimtarive, agjentëve dhe kushteve të punës, të parashikuara në këtë vendim, të jetë gjithmonë në përputhje me zhvillimet e fundit.

Inspektorati shqyrtton të paktën një herë në vit përmbajtjen e këtyre listave dhe i bën gjithë propozimet e duhura Ministrisë së Punës, për t’i paraqitur për miratim në Këshillin e Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi